



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1313/4 prot

Datë 12.07.2022

V E N D I M

Nr. 651/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-32719-06-13-2022, me objekt: “*Blerje të medikamenteve dhe materialeve mjekësore veterinare*”, me fond limit 23,834,700 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
Rruga “Murat Toptani” 1001, Ndërtesa 12, Kati 2, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Shehdula” SHPK
L.14, N.P. 20/298, ZK. 8616, Durrës

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e*

*Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.06.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-32719-06-13-2022, me objekt: “Blerje të medikamenteve dhe materialeve mjekësore veterinare”, me fond limit 23,834,700 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

II.2. Në datën 20.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1313/2022 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2290 e operatorit ekonomik “Shehdula” SHPK për procedurën e prokurimit. Ankimuesi kërkon modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 2803/1 prot., datë 23.06.2021, protokolluar me tonën me nr. 1313/2 prot., datë 27.06.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Shehdula” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Shehdula” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës duke pranuar pretendimet lidhur me produktin nr.12 “Vigon ngjyrë jeshil 18g”. Në lidhje me këtë pikë KSHA ka gjykuar, se ngjyra e produktit nuk është e rëndësishme, por vetëm funksionimi i tij dhe për këtë arsye pretendimi i ankimuesit është pranuar.

II.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 619/2022, datë 30.06.2022 ka vendosur:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-32719-06-13-2022, me objekt: “Blerje të medikamenteve dhe materialeve mjekësore veterinarë”, me fond limit 23,834,700 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.*
2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se:

1. *Produkti numer 3 “Spray Chlortetracycline x 200ml” ne regjistrin e PMV (Produkteve Mjekesore Veterinare) i referohet medikamentit SUPER’S CHLORTETRACYCLINE SPRAY i cili eshte i prodhuar nga kompania SUPER’S DIANA S. L., (ES) dhe tregtohet ne RSH VETEM nga 1 (nje) operator ekonomik. Per kete produkt ekzistojne produkte ekuivalente ne treg ne formen e sprayt lokal dhe me permbajtje antibiotiku qe kane te njejtin perdorim dhe kryejne te njejtin trajtim/efekt si medikamenti i kerkuar, ndaj kerkohet modifikimi i medikamentit ne “Spray me permbajtje antibiotiku per perdorim lokal ne kafshe”, duke mundesuar pjesemarrjen dhe te operatoreve ekonomike te tjere.*

2. *Produkti numer 4 “Leokoplast 1.25cm* 5mm” nga ana jone gjykohet se permasat jane nje gabim nga ana juaj, pasi nuk mund te ekzistojte nje gjatesi dhe gjeresi kaq joproportionale, qe e kthen ne nje produkt jo te vlefshem per perdorim ne kafshe. Kerkojme modifikimin duke perdorur termat “minimum” dhe “maksimum”per pjesen e permasave, duke zgjeruar llojshmerine e produkteve.*

3. Produkti numer 6 “Makine qethese model 220V 30W” 220 V dhe 30 Ë nuk jane model, por jane parametra teknike, ndaj kerkojme modifikimin duke perdorur termat “minimum” dhe “maksimum” per anen teknike te produktit.
4. Produkti numer 8 “Lincospectin, spectinomycin 100 ml” i referohet dy medikamenteve te ndryshme qe jane “lincomycine + spectinomycin inj” dhe “spectinomycin”. Kerkojme sakesimin se cili eshte preparati i kerkuar nga ana juaj.
6. Produkti numer 22 “Anestetike nderhyrje operative per qen me permbajtje ketamine+atropine+xylazine” ne regjistrin e PMV (Produkteve Mjekesore Veterinare) i referohet medikamentit KET A XYL? i cili eshte i prodhuar nga kompania PHARMADIX CORP. S.A./QUIMTIA S.A./ Agrovet Market Animal Health dhe tregtohet ne RSH VETEM nga 1 (nje) operator ekonomik, i cili eshte po i njejti operator ekonomik qe tregon produktin numer 3 “Spray Chlortetracycline x 200ml”. Ky eshte i vetmi produkt qe i permban te tre lendet aktive ne nje formulim te vetem, por ekziston mundesia qe ky medikament te perfitohet nga kombinimi i tre medikameneve Ketamine, Xylazine dhe Atropine, te cilat ofrohen nga disa operatore ekonomike ne RSH dhe jo nga NJE operator ekonomik i VETEM, sic eshte medikamenti i kerkuar.
7. Produkti numer 23 “Antibiotike peniciline streptomisine LA 100 ml” ne regjistrin e PMV (Produkteve Mjekesore Veterinare) i referohet medikamentit PENSTREP 20/20 L.A. i cili eshte i prodhuar nga kompania ANGLIAN NUTRITION PRODUCTS COMPANY (ANUPCO), United Kingdom dhe tregtohet ne RSH VETEM nga 1 (nje) operator ekonomik, i cili eshte po i njejti operator ekonomik qe tregon produktin numer 3 “Spray Chlortetracycline x 200ml” dhe produktin numer 22 “Anestetike nderhyrje operative per qen me permbajtje ketamine+atropine+xylazine”. Sa me siper kerkojme nga autoriteti kontraktor qe te kerkohet medikamenti “Antibiotike peniciline + streptomisine 100 ml”, i cili ofrohet nga disa operatore ekonomike.
8. Produkti numer 26 “Doreza speciale per kapjen e qenve”. Kerkojme sakesimin e materialit qe duhet te jene dorezat pasi fjala speciale nuk eshte ane teknike por nje term mjaft i gjere.
9. Produkti numer 44 “Antiparazitar i jashtem me permbajtje fipronil +methoprom”. Se pari, ju veme ne dijeni se produkti me permbajtjen e sakte eshte fipronil + (S)- METHOPRENE. Ne regjistrin e PMV (Produkteve Mjekesore Veterinare) i referohet medikamentit FRONTLINE COMBO SPOT-ON DOG (SMALL (S), MEDIUM (M), LARGE (L), EXTRA LARGE (XL), i cili eshte i prodhuar nga kompania Merial, France dhe tregtohet ne RSH VETEM nga 1 (nje) operator ekonomik, i cili eshte po i njejti operator ekonomik qe tregon produktin numer 3 “Spray Chlortetracycline x 200ml”, produktin numer 22 “Anestetike nderhyrje operative per qen me permbajtje ketamine+atropine+xylazine” dhe produktin numer 23 “Antibiotike peniciline streptomisine LA 100 ml”. Sa me siper kerkojme nga autoriteti kontraktor qe te kerkohet medikamenti “Antiparazitar i jashtem me pika per trajtimin e qenve”, i cili ofrohet nga disa operatore ekonomike.
10. Produkti numer 45 “Qafore antiparazitare me permbajtje imidocloprid 100 mg/gr, flumethrin 45 mg/gr, gjatesia 60-70 cm, pesha 45 gr”. Ne regjistrin e PMV (Produkteve Mjekesore Veterinare) i referohet medikamentit FORESTO 4.50 g+2.03 g, collar dogs > 8 kg, i cili eshte i prodhuar nga kompania KVP Pharma+Veterinar Produkte GmbH, Gjermani dhe tregtohet ne RSH VETEM nga 1 (nje) operator ekonomik, i cili eshte po i njejti operator

ekonomik qe tregton produktin numer 3 “Spray Chlortetracycline x 200ml”, produktin numer 22 “Anestetike nderhyrje operative per qen me permbajtje ketamine+atropine+xylazine”, produktin numer 23 “Antibiotike peniciline streptomisine LA 100 ml” dhe produkti numer 44 “Antiparazitar i jashtem me permbajtje fipronil +methoprom”. Sa me siper kerkojme nga autoriteti kontraktor qe te kerkohet medikamenti “Qafore antiparazitare gjatesia 60-70 cm” i cili ofrohet nga disa operatore ekonomike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit rezulton se është kërkuar si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Shiringa 20cc ml 3 + age 22g	copë	6,000
2	Shiringa 50cc ml 3 + age 22 g	copë	6,000
3	Spray Chlortetracycline x 200ml	copë	250
4	Leokoplast 1.25cm* 5mm	copë	500
5	Maska për qen masa M-L	copë	20
6	Makinë qethëse model 220V 30W	copë	3
7	Pompë dezinfektimi 15l-30l	copë	6
8	Lincospectin, spectinomycin 100 ml	flakon	150
9	Gentamicinë 5 % 100ml	flakon	150
10	Garza sterile 10x10cm	copë	3,000

11	<i>Cizme llastiku material PVC (nr te ndryshem sipas kerkesave te AK)</i>	<i>palë</i>	50
12	<i>Vigon ngjyrë jeshil 18g</i>	<i>copë</i>	2,000
13	<i>Darë matrikullimi</i>	<i>copë</i>	5
14	<i>Betadin ne ambalazh 1 liter</i>	<i>Litër</i>	30
15	<i>Matrikuj për qen</i>	<i>copë</i>	1,000
16	<i>Bisturi nr 21</i>	<i>copë</i>	1,000
17	<i>Zinxhir qafe material celik</i>	<i>copë</i>	50
18	<i>Pinca me dhëmbë</i>	<i>copë</i>	10
19	<i>Tasa ushqimi</i>	<i>copë</i>	100
20	<i>Rapid test Leishmania</i>	<i>copë</i>	2,000
21	<i>Vaksina Tërbimi ≥ 1 U.I</i>	<i>flakon</i>	2,000
22	<i>Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+xylazine</i>	<i>flakon</i>	2,000
23	<i>Antibiotikë peniciline streptomisine LA 100 ml</i>	<i>flakon</i>	150
24	<i>Ivermectinë 100ml</i>	<i>flakon</i>	200
25	<i>Alkol në ambalazh 1 litër</i>	<i>Litër</i>	100
26	<i>Doreza speciale për kapjen e qenve</i>	<i>palë</i>	100
27	<i>Ujë i oksigjenuar në ambalazh 1 litër</i>	<i>Litër</i>	10
28	<i>Serume Ringer 500ml</i>	<i>copë</i>	200
29	<i>Serume NaCl 500ml</i>	<i>copë</i>	200
30	<i>Serume Glukoze 5% 500ml</i>	<i>copë</i>	100
31	<i>Vaksinë polivalente për qen</i>	<i>flakon</i>	2,000
32	<i>Age G19</i>	<i>copë</i>	1,000
33	<i>Aparat Serumi</i>	<i>copë</i>	400
34	<i>Doreza Sterile Nr.7.5, Nr.8</i>	<i>palë</i>	3,000
35	<i>Doreza joSterile Nr.7.5, Nr.8</i>	<i>palë</i>	3,000
36	<i>Sutur USP nr. 1PGA+ Age 1-0</i>	<i>copë</i>	2,000
37	<i>Mbulesa një përdorimi sterile</i>	<i>copë</i>	1,500
38	<i>Përparëse operimi një përdorim</i>	<i>copë</i>	2,000
39	<i>Lak special për kapjen e qenve 150cm, kavo celiku I mbuluar me plastikë me mekanizëm me sustë</i>	<i>copë</i>	10
40	<i>Maska operacioni një përdorim</i>	<i>copë</i>	3,000
41	<i>Pinca hemostatike</i>	<i>copë</i>	10
42	<i>Mushama Shiu</i>	<i>copë</i>	100
43	<i>Ushqim për qen</i>	<i>kg</i>	5,000
44	<i>Antiparazitar i jashtëm me përmbajtje fipronil +methoprom</i>	<i>pipetë</i>	1000

45	<i>Qafore antiparazitare me përmbajtje imidocloprid 100 mg/gr , flumethrin 45 mg/gr, gjatësia 60-70 cm, pesha 45 gr.</i>	<i>copë</i>	<i>2,000</i>
46	<i>Portage</i>	<i>copë</i>	<i>10</i>
47	<i>Pinceta me dhëmbë</i>	<i>copë</i>	<i>5</i>
48	<i>Antiparazitar i brëndshëm me përmbajtje fenbendazol , pirantel , paraziquantel .</i>	<i>tableta</i>	<i>2,000</i>
49	<i>Përparëse të bardha masa L , XL , XXL</i>	<i>copë</i>	<i>30</i>

III.1.2. Referuar shkresës nr. 2803/1 prot., datë 23.06.2022, me objekt: “Kthim-përgjigje ankesës për procedurën me objekt: “Blerje të medikamenteve dhe materialeve mjekësore veterinarë” të autoritetit kontraktor protokolluar me tonën me nr. 1313/2 prot., datë 27.06.2021, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “Shehdula” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur mospranimin e ankesës për pretendimet e parashtuara në pikën III.1 të arsyetimit, si më poshtë vijon:

1. Për sa i përket pretendimit Tuaj në lidhje me produktin nr 3 “Spray Chlortetracyclirie x 200ml” ju sqarojmë se:

Kjo kerkese është vendosur në mbështetje të nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku citohet se: Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kerkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

KSHA, gjykon që produkti i kërkuar është vendosur vetëm lënda aktive e medikamentit dhe jo emri tregtar i produktit. Ky produkt përmban tetracycline që është një antibiotik me spekter të gjërë veprimi, duke na bërë të mundur aplikimin e tij në të gjitha rastet e infeksioneve nga një gamë e gjerë ngarkese mikrobike, e cila kerkon preparate efikase për vete faktin që qente endacake jetojnë në rrugë dhe plagët mund të riinfektohen në rastet që nuk mjekohen ashtu siç duhet. Lënda aktive Clortetracyclina ka dhënë rezultat shumë të mira në plagët kirurgjikale gjatë ndërhyrjeve në klinike, si dhe nga eksperiencat e mëparshme ka rezultuar shumë efikas dhe shumë cilesor, për këtë arsye është kërkuar e njehta lëndë aktive Chloretracyclina. Produkte me lëndën aktive Chlortetracycline prodhohen nga shumë kompani dhe tregtohen nga shumë subjekte në Shqipëri.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron.

2. Në lidhje me pretendimin Tuaj për produktin nr 4 "Leokoplast 1.25cm * 5mm" ju sqarojme se:

KSHA, gjykon se produkti i kërkuar është në permasat e kërkuara që i nevojitet Autoritetit Kontraktor, si dhe ka rezultuar shumë efikas në përdorim. Pas verifikimeve të bëra rezulton produkt që gjendet lehtësisht në treg.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron.

3. Për sa i përket pretendimit tuaj në lidhje me produktin nr 6 “Makine qethese model 220V 30W ”ju sqarojmë se:

Ne lidhje me pretendimin tuaj për sa i përket termit model apo parametra teknike ku ju pranoni vetë që nuk është model as marke por një parameter teknik. Makina qethese model 220V 30W është e njejta që është përdorur në klinikë, me rezultat dhe cilësi shume të mirë. Pretendimi juaj për këtë pikë nuk qëndron pasi kriteret teknike ne lidhje me specifikimet teknike të vendosura janë bërë sipas nevojave të Autoritetit dhe janë në diskrecionin e Autoritetit Kontraktor referuar ligjit nr. 162, date 23.1 2,2020 “Per prokurimin publik”, neni 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

4. Për sa i përket pretendimit tuaj në lidhje me produktin nr. 8 “Lincospretin, spectinomycin 100ml ”, ju sqarojmë se.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, të LPP, si dhe neni 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Produkti “Lincospectin, spectinomycin 100 ml”, është produkti mjekësor veterinar me përmbajtje lincomycin + spectinomycin 100 ml që përdoret gjerësisht kundër infeksioneve në kafshët e vogla. Është medikament me bazë të gjerë veprimi, i tregtuar nga shume subjekte në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

5. Për sa i përket pretendimit Tuaj në lidhje me produktin nr. 22 “Ariestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine + airopine + zylazinë ”, ju sqarojmë se:

Ju bëjmë me dije se kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 77, të ligjit nr. 1 62, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 2, të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku citohet se: Per mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike të cilat për minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

KSHA, gjykon se produkti Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+zylazinë është produkt mjekësor veterinar shumë i domosdoshëm për funksionin që kryen klinika jonë. Ky produkt është kërkuar me përmbajtje tre lëndesh aktive ketamine + atropine+zylazinë, në një produkt të vetëm, (pa përcaktuar sasine e çdo lënde aktive), pasi kjo lehtëson shumë punën operative të veterinerëve gjatë trajtimit të qenve endacakë, ku kërkohet mënyra me e shpejtë për një përdorim sa të lehtë, siguron veprim të sigurt dhe shmang komplikacionet e efektet anësore në kafshë, pasi vonesat në përdorim shkaktojnë incidente të mundshme nga agresiviteti i tyre, siç ka ndodhur në rastet kur janë përdorur 3 produkte të ndryshme ku secili ka vetëm një nga lëndet aktive të kërkuara.

Përdorimi i 3 produkteve veç e vec do të shkaktonte humbje në sasinë e përdorur, humbje kohe, efekt më të ngadaltë dhe mos efikasitet.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

6. Lidhur me produktin nr. 23 “Antibiotike peniciline streptomisine LA 100 ml” ju sqarojmë se:

Ju bëjmë me dije se kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku citohet se: Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në lidhje me këtë pikë që ju pretendoni, komisioni gjykon se produkti “Antibiotike peniciline streptomicinë LA 100 ml” është produkt që përmban penicilinë + streptomicinë me efekt të zgjatur që aplikohet çdo 72 orë. Aplikimi i këtij produkti çdo 72 orë ul stresin në kafshë, kohën dhe kostot e përdorimit në krahasim me antibiotikun me penicilinë + streptomisine 100 ml që ka përdorim çdo 24 ore dhe që kërkohet për 5 ditë rrjesht. Në këtë produkt është përcaktuar vetëm lënda aktive dhe jo emri tregtar. Nga kërkimet tona rezulton që kompania që ju referoheni Anglian Nutrition Products Company (Anupco) nuk operon me asnjë produkt në tregun e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu nga verifikimet në regjistrin e PMV-ve, rezulton që ka disa produkte tregtare nga kompani të ndryshme që kanë lëndën aktive të kërkuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

7. Lidhur me produktin nr. 26 “Doreza speciale për kapjen e qenve” ju sqarojmë se:

KSHA, gjykon për sa kohë nuk është vendosur saktësimi i materialit, i lihet hapësirë paraqitjes së një produkti me standarde për kapjen e qenve, i cili kryen funksionin e kërkuar duke u bazuar në vështirësinë që paraqet procesi i kapjes së qenve endacakë, duke krijuar mbrojtjen maksimale gjatë proceseve të trajtimit.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

8. Lidhur me produktin nr 44 “Antiparazitar i jashtëm me përmbajtje fipronil + methoprom” ju sqarojmë se:

Në lidhje me këtë pikë KSHA, “Antiparazitar i jashtëm me përmbajtje fipronil + methoprom”, është produkt i kërkuar nga klinka jonë me bazë fipronil +methoprom. Kjo lëndë aktive është provuar që ka dhënë rezultatet më të mira kundër parazitëve të jashtëm, është i lehtë në përdorim, kombinim i kësaj lënde aktive krijon një fushë të gjerë veprimi për parazitët e kafshëve endacake dhe ka shtrirje në kohë të efektit mbrojtjes pas aplikimit. Nga kërkimet tona rezulton që ka disa kompani që e tregtojnë këtë produkt në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

9. Lidhur me pretendimin tuaj për produktin nr.45, "Qafore antiparazitare me përmbajtje imidocloprid 100 m/gr, flumethrin 45 mg/gr, gjatësi 60-70 ccm, pesha 45 gr", ju sqarojmë se:

Në lidhje me këtë pikë KSHA, gjykon se është kërkuar një produkt me përmbajtje imidocloprid, jo me përcaktim tregtar. Kërkesa për lëndën aktive imidocloprid është përcaktuar bazuar dhe studimet e fundit laboratorike që janë kryer në vëndet e BE, pasi kjo lëndë aktive garaton mbrojtjen ndaj sëmundjes së leishmaniozes në qen dhe efekti i kollareve antiparazitare me përmbajtje imidocloprid zgjat mbi 7-8 muaj në krahasim me lëndet e tjera aktive, efekti i të cilave zgjat me pak se 2-4 muaj. Nisur nga pretendimet tuaja, komisioni bëri verifikimet përkatëse dhe rezultoi që ka disa kompani që prodhojnë kollare antiparazitare për qen me lëndën aktive të kërkuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron.

III.1.3. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik" përcaktohet se:

"1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) *kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

5. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

6. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët

dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: *"Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një*

punë, shërbim ose furnizim". Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "*specifikim teknik*" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.*"

III.1.5. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh" të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.1.6. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për sigurimin e produktit sa më cilësor me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatorët ekonomikë do të sigurojnë mall cilësor në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitja e pjesëmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

III.1.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për *Produktin numer 3 "Spray Chlortetracycline x 200ml"* se *ne regjistrin e PMV (Produkteve Mjekesore Veterinare) i referohet medikamentit SUPER'S CHLORTETRACYCLINE SPRAY i cili është i prodhuar nga kompania SUPER'S DIANA S. L., (ES) dhe tregtohet ne RSH VETEM nga 1 (nje) operator ekonomik. Per kete*

produkt ekzistojnë produkte ekuivalente ne treg ne formen e sprayt lokal dhe me permbajtje antibiotiku qe kane te njejtin perdorim dhe kryejne te njejtin trajtim/efekt si medikamenti i kerkuar, ndaj kerkohet modifikimi i medikamentit ne “Spray me permbajtje antibiotiku per perdorim lokal ne kafshe”, duke mundesuar pjesemarrjen dhe te operatoreve ekonomike te tjere”, sipas AK-së “produkti i kërkuar është vendosur vetëm lënda aktive e medikamentit dhe jo emri tregtar i produktit. Ky produkt përmban tetracycline qe është një antibiotik me spekter të gjerë veprimi, duke na bërë të mundur aplikimin e tij në të gjitha rastet e infeksioneve nga një gamë e gjerë ngarkese mikrobike, e cila kerkon preparate efikase për vete faktin që qente endacake jetojnë në rrugë dhe plagët mund të riinfektohen në rastet që nuk mjekohen ashtu siç duhet. Lënda aktive Clortetracyclina ka dhënë rezultat shumë të mira në plagët kirurgjikale gjatë ndërhyrjeve në klinike, si dhe nga eksperiencat e mëparshme ka rezultuar shumë efikas dhe shumë cilesor, për këtë arsye është kërkuar e njëjta lëndë aktive Chloretracyclina. Produkte me lëndën aktive Chlortetracycline prodhohen nga shumë kompani dhe tregtohen nga shumë subjekte në Shqipëri”.

III.1.7.1. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuzë, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Kpp gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë, se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, por duhet të përcaktojë specifikime të tilla me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Konkretisht, referuar edhe pretendimeve të ankimuesit, gjykojmë, se përcaktimi *Spray Chlortetracycline x 200ml* është përjashtues e kufizues, pasi rëndësi ka funksioni kryen produkti, dhe rezultati që pritët prej tij. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që produkti të ketë funksionin për tu aplikuar *në të gjitha rastet e infeksioneve nga një gamë e gjërë ngarkese mikrobike*, pra pa e kufizuar produktin e kërkuar, e cila mund të shkojë drejt një prodhuesi, por e rëndësishme është të realizojë këtë funksion pavarësisht mënyrës se si realizohet kjo.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës duke lejuar produkte ekuivalente të cilat realizojnë funksionin për luftimin e infeksioneve tek kafshët.

Rrjedhimisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.1.8. Lidhur me pretendimin 2 dhe 3 të ankimuesit se: *“Produkti numer 4 “Leokoplast 1.25cm* 5mm” nga ana jone gjykohet se permasat jane nje gabim nga ana juaj, pasi nuk mund te ekzistojte nje gjatesi dhe gjeresi kaq jo proporcionale, qe e kthen ne nje produkt jo te vlefshem per perdorim ne kafshe. Kerkojme modifikimin duke perdorur termat “minimum” dhe “maksimum” per pjesen e permasave, duke zgjeruar llojshmerine e produkteve” dhe “Produkti numer 6 “Makine qethese model 220V 30W” 220 V dhe 30 Ë nuk jane model, por jane parametra teknike, ndaj kerkojme modifikimin duke perdorur termat “minimum” dhe “maksimum” per anen teknike te produktit”, sipas autoritetit kontraktor “Në lidhje me pretendimin për produktin nr 4 "Leokoplast 1.25cm * 5mm",KSHA, gjykon se produkti i kërkuar është në permasat e kërkuara që i nevojitet Autoritetit Kontraktor, si dhe ka rezultuar shumë efikas në përdorim. Pas verifikimeve të bëra rezulton produkt që gjendet lehtësisht në treg”, “Për sa i përket pretendimit në lidhje me produktin nr 6 “Makine qethese model 220V 30W” [...] Makina qethëse model 220V 30W është e njëjta që është përdorur në klinikë, me rezultat dhe cilësi shume të mirë. Pretendimi nuk qëndron pasi kriteret teknike ne lidhje me specifikimet teknike të vendosura janë bërë sipas nevojave të Autoritetit dhe janë në diskrecionin e Autoritetit Kontraktor.”*

III.1.8.1. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse, por pa cenuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit/punës/mallit që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë.

K.P.P gjykon, se kërkesat e autoritetit kontraktor janë të ekzagjeruara, pasi nuk respektojnë testin e proporcionalitetit dhe kërkesat minimale që duhet të përmbushin specifikimet teknike në çdo rast duke evituar ato të dhëna që shkojnë drejt një marke apo prodhuesi të caktuar. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një minimum parametrash për të gjitha produktet në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

K.P.P gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike të mësipërme për sa i përket kontestimeve të ngritura nga ana e operatorit ankimues dhe të marrë masa për heqjen e specifikimeve kufizuese dhe përcaktuese, por të parashikojë të dhëna minimale ashtu sikurse parashikohet edhe në LPP, në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe jo parametra ekzakte të cilat kufizojnë konkurrencën dhe diskriminojnë operatorët ekonomikë të interesuar për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Ndaj autoriteti kontraktor duhet të ndryshojë diapazonin e parametrave (specifikimeve teknike) të përcaktuara në DST për produktin 4 dhe 6, duke përcaktuar parametra apo specifikime teknike me diapazon sa më minimal duke mos cenuar funksionimin e produkteve, pasi specifikimet teknike të përdorura nga autoriteti kontraktor bien ndesh me frymën dhe qëllimin e LPP për një pjesëmarrje të gjerë dhe konkurruese të operatorëve ekonomikë. Pra, autoriteti kontraktor duhet të rihartojë specifikimet teknike për produktet e mësipërme objekt-ankimi, duke përshtetur minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i përcakton mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, siç parashikohet në nenin 40 pika 2 e aktit normativ në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, si dhe duke i përcaktuar me diapazon ose minimum/maksimum kapacitet që lidhen me funksionalitetin e produkteve.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.1.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Shehdula” SHPK për artikujt 8 dhe 26 se: *“Produkti numer 8 “Lincospectin, spectinomycin 100 ml” i referohet dy medikamenteve te ndryshme qe jane “lincomycine + spectinomycin inj” dhe “spectinomycin”. Kerkojme saktessimin se cili eshte preparati i kerkuar nga ana juaj” dhe “Produkti numer 26 “Doreza speciale per kapjen e qenve”. Kerkojme saktessimin e materialit qe duhet te jene dorezat pasi fjala speciale nuk eshte ane teknike por nje term mjaft i gjere”, sipas autoritetit kontraktor “Përsa i përket pretendimit tuaj në lidhje me produktin nr 8 “Lincospretin, spectinomycin 100ml ”, ju sqarojmë se Produkti “Lincospectin, spectinomycin 100 ml”, është produkti mjeksor veterinar me përmbajtje lincomycin + spectinomycin 100 ml që përdoret gjerësisht kunder infeksioneve në kafshet e vogla. Është medikament me bazë të gjërë veprimi, i tregtuar nga shume subjekte në Republikën e Shqipërisë” dhe “Lidhur me produktin nr 26 “Doreza speciale për kapjen e qenve” ju sqarojmë se për sa kohë nuk është vendosur saktësimi i materialit, i lihet hapësirë paraqitjes së një produkti me standarde për kapjen e qenve, i cili kryen funksionin e kërkuar duke u bazuar në vështirësinë që paraqet procesi i kapjes së qenve endacakë, duke krijuar mbrojtjen maksimale gjatë proceseve të trajtimit. Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.”*

III.1.9.1. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi specifikimet teknike në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se dokumentet e tenderit janë kufizuese ose diskriminuese), por në thelb janë paqartësi mbi kërkesat e specifikimeve teknike. Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në përputhje me nenin 75 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit”,* ka dhënë sqarime të mjaftueshme dhe shteruese për operatorin ekonomik ankimues për paqartësitë tij, lidhur me kërkesat e tij për sqarim. Gjithsesi, Komisioni thekson, se këto sqarime duhet të publikohen në SPE në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

III.1.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Shehdula” SHPK për artikullin 22 *Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+xylazine,* sipas autoritetit kontraktor *“[...] produkti Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+zylazinë është produkt mjekësor veterinar shumë i domosdoshëm për funksionin që kryen klinika jonë. Ky produkt është kërkuar me përmbajtje tre lëndësh aktive*

ketamine + atropine+zylazinë, në një produkt të vetëm, (pa përcaktuar sasinë e çdo lënde aktive), pasi kjo lehtëson shumë punën operative të veterinerëve gjatë trajtimit të qenve endacakë, ku kërkohet mënyra me e shpejtë për një përdorim sa të lehtë, siguron veprim të sigurt dhe shmang komplikacionet e efektet anësore në kafshë, pasi vonesat në përdorim shkaktojnë incidente të mundshme nga agresiviteti i tyre, siç ka ndodhur në rastet kur janë përdorur 3 produkte të ndryshme ku secili ka vetëm një nga lëndët aktive të kërkuara. Përdorimi i 3 produkteve veç e veç do të shkaktonte humbje në sasinë e përdorur, humbje kohe, efekt më të ngadaltë dhe mos efikasitet.

III.1.10.1. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të ketë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse, por pa cenuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit apo të produktit që autoriteti kontraktor kërkon.

K.P.P, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për artikullin 22 *Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+xylazine* është e ekzagjeruar, pasi nuk respekton testin e proporcionalitetit dhe kërkesat minimale që duhet të përmbushin specifikimet teknike në çdo rast duke evituar ato të dhëna që shkojnë drejt një marke apo prodhuesi të caktuar. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një minimum parametrash për të gjitha produktet në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Autoriteti kontraktor duhet të lejojë mundësinë që ky medikament të përfitohet nga kombinimi i tre medikamenteve Ketamine, Xylazine dhe Atropinënë, pa qenë nevoja të përfshihen të tre elementet në të njëjtin produkt.

K.P.P gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike për artikullin 22, dhe të parashikojë të dhëna minimale ashtu sikurse parashikohet edhe në LPP, në funksion të

hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

III.1.11. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Shehdula” SHPK për artikullin 23 *Antibiotikë peniciline streptomisine LA 100 ml*, se: “*ne regjistrin e PMV (Produkteve Mjekesore Veterinare) i referohet medikamentit PENSTREP 20/20 L.A. i cili është i prodhuar nga kompania ANGLIAN NUTRITION PRODUCTS COMPANY (ANUPCO), United Kingdom dhe tregtohet ne RSH VETEM nga 1 (nje) operator ekonomik, i cili është po i njeiti operator ekonomik qe tregon produktin numer 3 “Spray Chlortetracycline x 200ml” dhe produktin numer 22 “Anestetike nderhyrje operative per qen me permbajtje ketamine+atropine+xylazine”. Sa me siper kerkojme nga autoriteti kontraktor qe te kerkohet medikamenti “Antibiotike peniciline + streptomisine 100 ml”, i cili ofrohet nga disa operatore ekonomike”, sipas autoritetit kontraktor “produkti “Antibiotike peniciline streptomicinë LA 100 ml” është produkt që përmban penicilinë + streptomicinë me efekt të zgjatur që aplikohet çdo 72 orë. Aplikimi i këtij produkti çdo 72 orë ul stresin në kafshë, kohën dhe kostot e përdorimit në krahasim me antibiotikun me penicilinë + streptomisine 100 ml që ka përdorim çdo 24 ore dhe që kërkohet për 5 ditë rresht. Në këtë produkt është përcaktuar vetëm lënda aktive dhe jo emri tregtar. Nga kërkimet tona rezulton që kompania që ju referoheni Anglian Nutrition Products Company (Anupco) nuk operon me asnjë produkt në tregun e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu nga verifikimet në regjistrin e PMV-ve, rezulton që ka disa produkte tregtare nga kompani të ndryshme që kanë lëndën aktive të kërkuar.”*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkua, parashikuar edhe nga neni 40 pika 2 e aktit normativ në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publike është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. Vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për sigurimin e produktit sa më cilësor me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitja e pjesëmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomik. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për produktin 23 duhet të përshkruajë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që e përcakton produktin si të

pranueshëm për funksionet e kërkuara, siç parashikohet në nenin 40 pika 2 e aktit normativ në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.12. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për produktet 44 *Antiparazitar i jashtëm me permbajtje fipronil +methoprom* dhe 45 “*Qafore antiparazitare me permbajtje imidocloprid 100 mg/gr, flumethrin 45 mg/gr, gjatesia 60-70 cm, pesha 45 gr*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuzë, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, por duhet të përcaktojë specifikime të tilla me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Konkretisht, referuar edhe pretendimeve të ankimuesit, gjykojmë, se përcaktimet “*Antiparazitar i jashtëm me permbajtje fipronil +methoprom*” dhe “*Qafore antiparazitare me permbajtje imidocloprid 100 mg/gr, flumethrin 45 mg/gr, gjatesia 60-70 cm, pesha 45 gr*” janë përjashtuese e kufizuese për kompanitë që i ofrojnë këto produkte, duke siguruar funksionalitetin e kërkuar dhe rezultatet që priten prej tyre. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që produkti “*Antiparazitar i jashtëm*” të ketë rezultate të mira kundër parazitëve të jashtëm dhe shtrirje në kohë të efektit mbrojtjes pas aplikimit. Gjithashtu edhe kërkesat për produktin 45, “*Qafore antiparazitare*” duhet të garantojnë mbrojtjen ndaj sëmundjes së leishmaniozes në qen dhe efekti i antiparazitarëve të zgjatë jo më pak se 2-4 muaj. Pra në të dyja rastet autoriteti kontraktor duhet të përshkruajë në specifikimet teknike kërkesat e tij për produktet e kërkuara, në funksion të nevojave të tij, duke lejuar produkte ekuivalente të cilat realizojnë funksionin për luftimin e infeksioneve tek kafshët, përshkruar si në specifikimet teknike dhe në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ si më sipër cituar.

Rrjedhimisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Shehdula” SHPK se: “Lidhur me kriterin 2.3.4. ju qartesojmë se produktet mjekësore veterinarë të cilat janë të miratuara për tu tregtuar në territorin e Republikës së Shqipërisë referuar nën 85, pika 1 dhe pika 5 e Ligjit Nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për tu regjistruar shoqërohen me dokumentacionin e posaçëm nga prodhuesi, i cili pasi verifikohet nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve, pajis me certifikatë tregtimi distributorin e autorizuar nga kompania prodhuese. Për sa kohë Lista e PMV-ve të regjistruara është e miratuar zyrtarisht nga autoritetet kompetente në RSH dhe është e aksesueshme lehtësisht elektronikisht në websitet e përmendura më sipër, nuk është e nevojshme që distributori i autorizuar i mallrave të paraqesë dokumentacionin përkatës nga ku, të vërtetohet lidhja midis tyre (distributor-prodhues). Në territorin e Republikës së Shqipërisë ekzistojnë mbi 10 (dhjetë) operatore ekonomike, të cilat janë distributor të autorizuar të PMV (Produkteve Mjekësore Veterinarë), ku përfshihen dhe medikamentet e kerkuara në këto procedura prokurimi. Secili prej tyre mund të tregtojë disa nga këto produkte, por asnjë nuk i tregton njëkohësisht të gjithë produktet mjekësore veterinarë të kerkuara në këto procedura. Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj që përveç autorizimit distributori i autorizuar - tregtues i autorizuar të pranohen dhe fatura tatimore blerje nga distributori i autorizuar (sipas listës së miratuar të PMV-ve të regjistruara në RSH), ku të jenë përcaktuar qartësisht specifikimet teknike të produkteve mjekësore veterinarë të kerkuara nga ana juaj. Fatura e blerjes përmban të gjithë elementet e domosdoshëm që ju si autoritet kontraktor të verifikoni lidhjet e kerkuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4 e dokumenteve të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë për Produktet Mjekësore Veterinarë nëse është prodhues/ distributori i autorizuar ose tregtues i autorizuar nga prodhuesi/ distributori i autorizuar i mallrave për artikujt për këtë objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues/ distributori i autorizuar i mallrave duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre (ofertues-distributor-prodhues) duke paraqitur kontratë furnizimi ose letër angazhimi/ akt-marreveshje (ose ekuivalent). Në rast se ofertuesi është distributori i autorizuar i mallrave duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës nga ku, të vërtetohet lidhja midis tyre (distributor-prodhues). Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si telefon, fax, email, website. Kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. (Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit).

III.2.2. Nëpërmjet shkresës nr. 2803/1 prot., datë 23.06.2021, protokolluar me tonën me nr. 1313/2 prot., datë 27.06.2021, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon: “Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autoriteti

kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose / distributori i autorizuar ose tregtues i autorizuar nga prodhuesi, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit / distributori i autorizuar ose tregtues i autorizuar nga prodhuesi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave, siguron cilësinë e produktit dhe shmang falsifikimet e ndryshme. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për produktet e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të produkteve, dhe nevojës për garanci mbi treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.”

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.5. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.6. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3, 6 dhe 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

[...]

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

[...]

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo

gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

[...]

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.2.7. Nga shqyrtimi i “Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, të publikuar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me kriterin e mësipërm, ky i fundit argumentuar: **“Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose / distributori i autorizuar ose tregtues i autorizuar nga prodhuesi, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit / distributori i autorizuar ose tregtues i autorizuar nga prodhuesi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmimeve nga prodhuesi për produktet e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të produkteve, dhe nevojës për garanci mbi treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës”.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.4 të kriterëve të kualifikimit si më sipër cituar, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Dokumentacioni mund të sigurohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, por edhe në çdo formë tjetër që vërteton lidhjen ndërmjet palëve. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar prej tij. Në këtë kontekst, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të mësipërm nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Akoma më tej, KPP gjykon se, dokumentacioni i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë ndaj dhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Shehdula” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-32719-06-13-2022, me objekt: “Blerje të medikamenteve dhe materialeve mjekësore veterinare”, me fond limit 23,834,700 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 29.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe vendimit të KSHA-së.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Shehdula” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

